

Augustin Palokaj & Gjeraqina Tuhina

---

# Çfarë pas MSA në raportet Kosove-BE

---

*Nëntor 2016*



Augustin Palokaj & Gjeraqina Tuhina

# Çfarë pas MSA: Raportet Kosovë-BE

Nëntor 2016

**Titulli:**

Çfarë pas MSA: Raportet Kosovë-BE

**Autor:**

Augustin Palokaj & Gjeraqina Tuhina

**Publikuar nga:**

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur



Ky projekt është financuar nga granti i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur. Opinionet, gjetjet dhe përfundimet e shprehura në këtë raport janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e KFOS-it.

# Përmbajtja

---

- 5 Hyrje:
- 7 Kronologjia e raporteve BE – Kosovë
- 9 Sfida e parë – zbatimi i MSA-së
- 11 Hapi i ardhshëm në përafrimin me Kosovën, përfshirë kërkesën formale për anëtarësim
- 15 Dallimi ndërmjet MSA-së me Kosovën dhe MSA-ve me vendet tjera të rajonit
- 17 Pak entuziazëm brenda Bashkimit European sa i përket zgjerimit
- 21 Konkluzionet
- 23 Rekomandimet

---

# Hyrje

---

Me 1 prill të vitit 2016 hyn në fuqi Marrëveshja e Stabilizim Asocimit në mes të Kosovës dhe Bashkimit Europian, e cila paraprakisht u botua në gazetën zyrtare të BE-së. Kjo shënon hapin më të rëndësishëm deri me tani në raportet e BE-së me Kosovën, si në aspektin juridik - në formën e vendosjes së raporteve kontraktuale - ashtu edhe në aspektin ekonomik, tregtar, politik dhe më gjërë. Padyshim se hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje ka rëndësi historike dhe përfaqësuesit politikë, edhe të Kosovës edhe të BE-së, nuk ekzagjerojnë kur kësaj MSA-je i japin rëndësi të tillë. Me hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje, Kosova përmbyll një proces të gjatë dhe jo të lehtë në ndërtimin e raporteve kontraktuale me BE-në, ia hap vetes mundësitë e mëdha për qasje në tregun e BE-së, përfiton nga mundësitë e shumta që krijon kjo marrëveshjeje përmes zbatimit të së cilës do të bëhen reforma që do ta ndryshojnë për të mirë vendin dhe shoqërinë. Edhe BE-ja me këtë përmbyll një proces të gjatë, të nisur që nga Samiti i Zagrebit në vjeshtën e vitit 2000. Në këtë samit, praktikisht u lansua Procesi i Stabilizim Asocimit dhe u përmend perspektiva europiane e rajonit, duke e kushtëzuar atë me bashkëpunimin rajonal.

Pikërisht me Marrëveshjen me Kosovën Bashkimi Europian përmbyll rrethin e marrëveshjeve të tilla me të gjitha shtetet e rajonit që në fjalorin e saj përkufizohet si “Ballkani Perendimor” e që në fakt përfshin shtetet e krijuara në territorin e ish-Jugosllavisë (me përjashtim të Sllovenisë), plus Shqipërinë. Prandaj MSA-ja me Kosovën ka padyshim

rëndësi historike edhe për Bashkimin Europian i cili përmes këtij procesi të Stabilizim Asocimit tashmë ka arritur të ndihmojë që këto vende të arrijnë stabilizimin në atë masë sa të mund të asociohen me BE-në.

Por, sikur edhe shumë gjëra tjera në rastin e Kosovës, edhe kjo Marrëveshje është një “sui generis” krahasuar me marrëveshjet e ngjashme që BE-ja i ka arritur me shtetet tjera. Në pjesën më të madhe, ajo përfshin gjërat e njëjta sikur edhe marrëveshjet e tjera por në aspektin juridik, nënshkrimi i saj është bërë vërtet nga institucionet e BE-së e jo nga shtetet anëtare, ndërsa edhe premtimet politike për përparim të Kosovës drejt integritit të plotë në BE janë më të zbehta, apo edhe të kushtëzuara me “rrethanat”. Kjo për shkak se Kosova është njohur si shtet nga pjesa dërmuese e Bashkimit Europian, por megjithatë nuk njihet nga 5 shtetet anëtare të BE-së. Prandaj, sa mund të konsiderohet sukses mënyra se si u gjet formula ligjore që edhe me Kosovën të bëhet një Marrëveshje e tillë, pa paragjykuar qëndrimet e shteteve anëtare të BE-së ndaj statusit, po aq mund të konsiderohet edhe pengesë për raportet e ardhshme në procesin e integritimit të Kosovës drejt Bashkimit Europian.

Ndërkohë, i gjithë procesi i zgjerimit të BE-së është hequr nga fokusi primar, sa për shkak të faktit se vërtetë të gjitha vendet e rajonit janë ende shumë larg nga përmbushja e kriterëve për anëtarësim, aq edhe për shkak të problemeve të brendshme që ka BE-ja. Bashkimi Europian vazhdon ta mbajë gjallë procesin e zgjerimit,

---

duke bërë hapa në proceset e bisedimeve me shtetet e rajonit, por në të njëjtën kohë rritet edhe hezitimi edhe kundërshtimi për pranimin e shteteve të reja. Simodos tash, me vendimin e qytetarëve të Mbretërisë së Bashkuar në referendum që të dalin nga BE-ja, për herë të parë në histori kemi një rast të shpërbërjes së BE-së dhe nisjes së procesit të ngushtimit (ose tkurrjes). Atmosfera në BE, edhe si pasojë e dëshpërimit me vendimin e Britanisë për t'u larguar nga Unioni, është e tillë sa që disa politikanë seriozë nuk hezitojnë të tërheqin vërejtjen se, nëse nuk tejkalohet kjo sfidë, mund të vie edhe deri tek shkatërrimi i BE-së.

Në këto rrethana, sa është reale të pritët që Kosova t'i bëjë hapat e ardhshme në procesin e integrimi evropiane, dhe cilat do të jenë prioritetet dhe mundësitë në raportet e Kosovës me BE-në pas hyrjes në fuqi të MSA-së? Kjo është temë e këtij studimi, i cili është bërë duke u bazuar në dokumentet ekzistuese, bisedat dhe burimet zyrtare por edhe jozyrtare me akterë të përfshirë në proces.

# Kronologjia e raporteve BE – Kosovë

- **2000** – Në Samitin e Zagrebit, të mbajtur më 24 nëntor të këtij viti, BE-ja premton përafrim drejt integritit për vendet e rajonit. Kosova në këtë samit nuk merr pjesë ndërsa si mysafir i pranishëm është Shefi i Misionit të UNMIK-ut. Në deklaratën formale të samitit përmenden pesë shtete. Këtu mungon Kosova dhe Mali i Zi – të cilat u pavarësuan më vonë. Si kusht për integrim në BE përmendet bashkëpunimi rajonal.
- **2002** – Themelohen Mekanizmat Përcjellës të Stablizim Asocimit për Kosovën. Këto shërbenin që të përgaditët vendi për momentin kur krijohen kushtet për përfshirje formale në proces.
- **2003** – Samiti i Selanikut i mbajtur në qershor doli me deklaratë të përbashkët të krerëve të shteteve dhe qeverive të shteteve anëtare të Bashkimit Europian me ç'rast u konfirmua perspektiva e integritit europian të të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor<sup>1</sup>. Kosova nuk anashkalohet nga kjo deklaratë ndonëse kërkohet plotësimi i standardeve në mënyrë që të ecet drejt përcaktimit të statusit, me çka hapet mundësia e jetësimi të perspektivës europaine.
- **2005** – Dokumenti që i referohet perspektivës europiane të Kosovës për herë të parë përmend integrimin e plotë të Kosovës në Bashkimin Europian. Dokumenti identifikon mungesën e statusit si pengesë për nisjen e procesit të Stablizimit Asocimit. Qëllimi i këtij procesi, sipas dokumentit në fjalë, është integrimi i plotë në BE<sup>2</sup>. Pavarësisht mungesës së statusit, me këtë rast Komisioni Europian premton të gjejë “mënyra kreative” që edhe Kosova të përfitojë nga instrumentet e BE-së.
- **2007** – Periudha e negociatave të statusit të ndërmjetësuar nga Maarti Ahtisari. Përfaqësuesi i lartë i BE-së, Javier Solana, dhe Komisioneri për Zgjerim, Olli Rehn, përpiluan raportin e përbashkët i cili parashihte perspektiven europiane edhe të Kosovës, njëjtë sikur të vendeve tjera të rajonit<sup>3</sup>. Ky dokument parasheh mundësinë e Procesit të Stablizim Asocimit për Kosovën pas përcaktimit të statusit. Raporti nënvizon se Kosova duhet t'i përmbushë të gjitha kushtet sikur secili shtet tjetër i Ballkanit Perëndimor. Njëkohësisht theksohet se Kosova duhet të ndjejë se edhe BE-

2 EU. (2005, April ). A European Future for Kosovo. retrived from <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:52005DC0156>

3 <sup>2</sup> Commission, E. (2007, March 29). Joint report by Javier SOLANA, EU high representative for the CFSP and Olli REHN, EU commissioner for enlargement, on the state of preparations of the future EU and international presence in Kosovo. Retrieved from [http://europa.eu/rapid/press-release\\_MEMO-07-121\\_en.htm](http://europa.eu/rapid/press-release_MEMO-07-121_en.htm)

1 EU. (2003, June 21). EU-Western Balkans summit Thessaloniki, 21 June 2003. Retrieved from [http://europa.eu/rapid/press-release\\_PRES-03-163\\_en.htm](http://europa.eu/rapid/press-release_PRES-03-163_en.htm)



- ja është e përkushtuar të angazhohet në raportet kontraktuale, të kultivojë bashkëpunimin rajonal si dhe të ofrojë të njëjtat mundësi që i ka edhe pjesa tjetër e rajonit.
- **2009** – Komisioni Europian publikon një “Studim”<sup>4</sup> për Kosovën pas pavarësisë. Në atë kohë, Kosovën e pavarur e kishte njohur pjesa dërmuese e shteteve anëtare të Bashkimit Europian, pos pesëshes. Pesëshja ka ndikuar te strukturat e Komisionit që dokumenti në fjalë të quhet “Studim” e jo Studim Fizibiliteti ashtu siç ka qenë praktika për secilin vend tjetër të rajonit të Ballkanit Perëndimor e që ka të bëjë me gatishmërinë e një shteti që të nisë procesin e stabilizim asociimit që normalisht çon deri te nënshkrimi i MSA-së. Ky studim thekson domosdoshmërinë që mungesa e njohjes nga të gjitha anëtarët e BE-së nuk duhet të jetë pengesë në raportet ndërmjet BE-së dhe Kosovës. Ky dokument rekomandon nisjen e dialogut për vizat por edhe nisjen e “dialogut të stabilizim asociimit” i cili sipas këtij dokumenti, thëllon dhe forcon pjesëmarrjen e Kosovës në Procesin e Stabilizim Asociimit.
  - **2012** – Publikohet Studimi i Fizibilitetit për Kosovën<sup>5</sup>. Porosia kyçe nga ky dokument është se nuk ka pengesa legale që Kosova të nënshkruajë MSA-në. Identifikohen edhe fushat ku Kosova duhet të ndërmarrë reforma serioze: Sundimi i ligjit, administrate publike, mbrojtja e minoriteteve dhe tregtia.
  - **2013** – Në qershor, Këshilli i Bashkimit Europian jep dritën e gjelbër për nisje të negociatave të stabilizim asociimit. Takimi i parë mbahet në tetor të po këtij viti.
  - **2014** – Në periudhën maj-qershor përmbyllet negociatat për MSA-në dhe parafohet teksti i marrëveshjes.
  - **2015** – Më 27 tetor, në Straburg nënshkruhet Marrëveshja e Stabilizim Asociimit në mes të Kosovës dhe Bashkimit Europian. Për herë të parë aplikohet parimi “EU only” ku marrëveshjen e nënshkruajnë përfaqësuesit e institucioneve europiane në vend të përfaqësuesve të secilit shtet anëtar.
  - **2016** – MSA-ja mes Kosovës dhe Bashkimit Europian hynë në fuqi më 1 prill.

4 Commission, E. (2009). *COMMUNICATION FROM THE COMMISSION TO THE EUROPEAN PARLIAMENT AND THE COUNCIL Kosovo \* -fulfilling its European perspective* \*. Retrieved from [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2009/kosovo\\_study\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2009/kosovo_study_en.pdf)

5 EU. (2012). *COMMUNICATION FROM THE COMMISSION TO THE EUROPEAN PARLIAMENT AND THE COUNCIL on a feasibility study for a Stabilisation and association agreement between the European Union and Kosovo* \*. Retrieved from [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2012/package/ks\\_feasibility\\_2012\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/ks_feasibility_2012_en.pdf)

# Sfida e parë – Zbatimi i MSA-së

---

Sa herë që ndërmerret një hap në një proces të gjatë, siç është ai i integritimeve europiane, parashtrahet pyetja se cili do të jetë hapi i ardhshëm. Kështu, edhe pas hyrjes në fuqi të MSA-së mes Kosovës dhe BE-së, me të drejtë parashtrahet pyetja se çka tutje. Si të shfrytëzohet kjo MSA si fillim i një periudhe të re në vend që të kuptohet si fund i një procesi.

Kur zyrtarëve të BE-së në Bruksel u bëhet pyetja se çka do të pasojë tash, pas hyrjes në fuqi të MSA-së, ata pothuajse njëzëri përgjigjen: “tash fokusi duhet të jetë në zbatimin e MSA-së”. Zyrtarët e BE-së dërgojnë porosi të tilla që nga koha kur edhe hyri në fuqi MSA-ja.

Në komunikatën e lëshuar nga BE-ja më 1 prill të vitit 2016, ditën e hyrjes në fuqi të MSA-së, Përfaqësuesja e lartë për politikë të jashtme dhe siguri Federika Mogherini dhe Komisioneri për politika të fqinjësisë dhe të zgjerimit, Johannes Han, e quajten këtë marrëveshje si të rëndësishme për të stimuluar reformat në Kosovë<sup>6</sup>.

“Kjo marrëveshje hap një fazë të re në marrëdhëniet BE-Kosovë dhe paraqet kontribut të rëndësishëm për paqe, stabilitet dhe prosperitet në Kosovë dhe në rajon në përgjithësi. Unë pres zbatimin e kësaj marrëveshjeje” ka thënë Përfaqësuesja e lartë Mogherini. Ndërsa Komisioneri Han veçoi

rëndësinë për investime.

“Kjo marrëveshje është moment historik për marrëdhëniet BE-Kosovë: ajo do ta ndihmojë Kosovën në rrugën e reformave dhe do të krijojë mundësi për tregti dhe investim” pati thënë ai.

Zyrtarët e BE-së në reagimet e tyre nuk përmendnin mundësinë e ndonjë hapi tjetër në proces, por insistonin që tash gjithçka të fokusohet në implementimin e MSA-së, që paraqetsfidëtëmadhe. Kjomarrëveshjerregullon tregtinë me BE-në, ndihmon harmonizimin e legjislacionit, bashkëpunimin në fushën e migrimit, luftës kundër trafikimit, pastrimit të parave, terrorizmit. Me të themelohet Këshilli i Stabilizim Asocimit si dhe Komisionet e përbashkëta që do të takohen rregullisht dhe do ta mbikqyrin zbatimin e Marrëveshjes. Poashtu vendosen edhe metodologjitë për zgjidhjen e mospajtimeve mes palëve nënshkruese.

Vetë teksti i Marrëveshjes cakton dhe afatet kalimtare deri kur do të duhet të implementohen pjesët dhe fushat e parapara në marrëveshje. Kosovës i është dhënë afat prej 10 vjetësh për zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Kjo është e favroshme për Kosovën sepse BE-ja e hap më shpejtë tregun e saj për prodhimet nga Kosova, ndërkohë që Kosovës i jepet mundësi që tregun e vetë ta hapë gradualisht.

Në shikim të parë, duket se nuk do të ketë probleme në zbatimin e Marrëveshjes për

---

<sup>6</sup> Deklaratë për shtyp e Përfaqësueses së lartë Mogherini dhe Komisionerit Hahn. 1 prill 2016

---

shkak të mosnjohjes së Kosovës nga disa vende anëtare të BE-së, por probleme të tilla as nuk mund të përjashtohen sepse vendeve në disa raste u lejohet mundësia që të zbatojnë legjislacionet nacionale.

Bashkimi European do të bëjë monitorimin e zbatimit të MSA-së, do të përgatisë raporte progresi rreth këtij zbatimi, do të formulojë edhe pozicionet e përbashkëta për takimet me palën kosovare. Por ajo që ka ndodhur për vendet tjera, e nuk pritet të ndodhë për Kosovën - së paku jo në një fazë të hershme - është hapi tjetër formal në procesin e integritimeve. E hapi formal në rastin e secilit shtet pas MSA-së ka qenë dorëzimi i kërkesës për anëtarësim në BE.

# Hapi i ardhshëm në përafrimin me Kosovën, përfshirë kërkesën formale për anëtarësim

---

Kosova është vendi i fundit që ka nënshkruar MSA-në me Bashkimin Europian dhe tash është vendi i vetëm i rajonit i cili nuk e ka bërë kërkesën formale për t'u bërë anëtar i BE-së. Pas hyrjes në fuqi të MSA-së, e në disa raste edhe më herët, hapi i cili ka pasuar ka qenë pikërisht aplikimi për anëtarësim dhe sigurimi i statusit të kandidatit.

Por në rastin e Kosovës nuk pritet të ndodhë një gjë e tillë për shkak të pengesave ligjore që lidhen me statusin e Kosovës. Ato pengesa disi u tejkaloan gjatë një procesi shumë të gjatë për të siguruar këtë MSA, sado që ajo dallon në disa raste nga të tjerat, por duket se me këtë BE-ja i ka prekur kufijtë e gjetjes së formulave për të arritur përparim me Kosovën në procesin e integrimi, pa pasur nevojë për të qenë e njohur nga të gjitha shtetet. Dhe MSA-ja e bën të qartë se Kosova me këtë Marrëveshje nuk njihet si shtet dhe marrëveshja nuk paragjykon qëndrimet e shteteve anëtare ndaj statusit.

Arikulli 49 i Traktatit të BE-së, i cili është edhe bazë që cakton kushtet për nisjen e procesit të zgjerimit me një vend, përmend qartë se secili “shtet” mund të aplikojë për anëtarësim. Pra përmendet termi “shtet”, që në rastin e

Kosovës për momentin vendos pengesë të pakapërcyeshme ligjore.

Ndonëse në BE bëjnë përpjekje maksimale për të mos folur shumë për këtë gjë, duke tentuar të lënë përshtypjen se procesi është më i rëndësishëm se forma, të gjithë privatisht e pranojnë se Kosova nuk mund të bëhet vend me statusi kandidati pa u njohur nga të gjitha vendet anëtare. Në një intervistë për të përditshmen kosovare, Koha Ditore, këtë e kishte thënë edhe vetë komisioneri që merret edhe me zgjerimin, Johannes Han.

Pyetja e gazetës ishte: Hapi i natyrshëm pas MSA-së do të duhej të ishte aplikimi për anëtarësim në BE. A mund ta bëjë Kosova legalisht këtë dhe ta marrë statusin e kandidatit pa qenë e njohur nga të gjitha shtetet anëtare?

Han ishte përgjigjur: “Jo, ju duhet të jeni të njohur nga të gjitha shtetet. Por tash fokusi duhet të jetë që vendi të zhvillohet ekonomikisht, të ketë rritje, krijim të vendeve të punës. Kemi bërë shumë për të arritur këtë Marrëveshje, e cila i ka më shumë se 500 faqe. Për momentin do të fokusohemi në zbatimin e saj. Mendoj se kjo është e rëndësishme edhe për qytetarët sepse nuk ia vlen të humbim shumë energji

---

duke diskutuar teoritë. Ti bëjmë së pari gjërat e para”<sup>7</sup>.

Prandaj edhe mund të konstatohet se MSA-ja për një kohë shumë të gjatë do të jetë dokumenti i cili do të rregullojë raportet e Kosovës me BE-në dhe se nuk do të ketë ndonjë hap tjetër formal në një të ardhme të afërt. Kjo do të mund të ndodhte sikur të kishte ndonjë paralajmërim, apo mundësi reale, që shtetet të cilat kundërshtojnë shtetësinë e Kosovës të ndryshojnë mendjen, por kjo nuk pritet të ndodhë, As ato nuk kanë vullnet për të ndryshuar qëndrimet, as nuk u kërkohet një gjë e tillë. Me përjashtim të Parlamentit Europian, i cili vazdimisht kërkon nga pesë shtetet anëtare që nuk e kanë njohur Kosovën si shtet që ta bëjnë sa më parë një gjë të tillë, nuk ka kurrfarë presioni ndaj atyre shteteve nga ndonjë strukturë tjetër europiane. Shërbimi i veprimit të jashtëm europian (EEAS), i cili koordinon politikën e jashtme të BE-së, dhe Komisioni Europian, kënaqen me “mbështetjen konstruktive” që këto shtete japin duke mos e penguar Kosovën në procesin e Stabilizim Asocimit, ose në procesin e liberalizimit të vizave, por nuk u kërkojnë njohje, as për të ndihmuar që, së paku në rastin e Kosovës, BE-ja të flasë me një zë unik. Në këtë mënyrë të gjitha institucionet e BE-së, me përjashtim të Parlamentit Europian, vazhdojnë të kenë qëndrim “neutral ndaj statusit”.

Nga aspekti politik disa diplomatë të vendeve anëtare që nuk e kanë njohur Kosovën në bisedë me autorët e këtij punimi madje kanë thënë se nga zyrtarët e institucioneve u është thënë se “në këtë mënyrë kanë ndihmuar që BE-ja të jetë ndërmjetësuesi më i mirë i mundshëm në dialogun mes Prishtinës dhe Beogradit”.

“Kjo është edhe përparësi, sepse kjo na mundëson që ne të jemi lehtësuesi më i mirë i mundshëm i dialogut mes Kosovës dhe Serbisë, duke qenë neutral. Kosovarëve u themi se pavarësia e tyre është punë e kryer, sepse shumica e madhe e vendeve anëtare e kanë njohur, ndërsa serbëve u themi se pese shtetet e BE-së nuk e njohin Kosovën, prandaj jemi neutralë ndaj statusit” ka përsëritur para disa vitesh një prej zyrtarëve më të lartë të BE-së i përfshirë në lehtësimin e dialogut. Shikuar nga qasja teorike, kjo edhe duket e logjikshme, edhe pse mund t’u japë të drejtë atyre që thonë se, për shkak të dialogut, Kosova mund të ketë edhe pengesa.

Edhe pse në arsyetimet e tyre pse nuk e njohin Kosovën shumica e vendeve thonin se e “respektojnë të drejtën ndërkombëtare” ato nuk e ndryshuan qëndrimin as pas mendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë e cila tha se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk paraqet shkelje të së drejtës ndërkombëtare. Edhe pse disa nga ato shtete, si për shembull Spanja, patën insistuar në shkurt të vitit 2008, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, se BE-ja në deklaratën e saj të theksojë se “ky është një rast i veçantë”, nuk ka dyshim se mosnjohja ishte e motivuar edhe nga aspiratat e disa rajoneve për shpëputje. E situata në këtë drejtim tash është edhe më e komplikuar sesa që ishte para 8 vitesh. Katalonia tashmë paralajmëron shpëputje, dhe nuk pritet që të ketë ndryshim pozicioni në rastin e Kosovës. Edhe disa nga shtetet tjera, kur thonë se mund të lëvizin nga qëndrimi i tyre, këtë e kushtëzojnë me një Marrëveshje mes Kosovës dhe Serbisë. Duke pasur parasysh se vetë dialogu do të zgjasë edhe shumë vite - mbase edhe deri tek anëtarësimi i

---

<sup>7</sup> Intervistë botuar në Koha ditore me 6 Nëntor 2015

mundshëm i Serbisë në BE - është edhe më pak reale të pritët ndonjë ndryshim i qëndrimeve.

Kjo situatë, e cila nuk pritët të ndryshojë në një të ardhme të afërt, do të bëjë që raportet e Kosovës me BE-në të hynë në një staus quo të re: me MSA dhe asgjë më shumë tjetër. Kjo kosovarëve do t'ua rrisë edhe më shumë ndjenjën e izolimit nga BE-ja sepse, edhe pse me hapa shumë të ngadalësuar, vendet tjera të rajonit po lëvizin përpara. Mali i Zi dhe Serbia tashmë negociojnë anëtarësimin; Shqipëria dhe Maqedonia e kanë edhe stausin e kandidatit, ndërsa edhe për Bosnjën e Hercegovinën Komisioni European ka marrë mandatin nga Këshilli që të nisë përpilimin e mendimit për dhënien e stausit të kandidatit.

Kjo situatë e sqaron edhe pse në MSA nuk përmendet integrimi i Kosovës në BE, që e bën atë pak më të ndryshme nga Marrëveshjet me vendet tjera.

---

# Dallimi i MSA-së me Kosovën me ato me vendet tjera të rajonit

---

Ndonëse nuk dallohen shumë në shikim të parë për nga gjuha por edhe forma, MSA-ja e Kosovës megjithatë është më ndryshe nga ato me vendet tjera. Që në kohën kur kishte nisur procesi i përgatitjes së nisjes së negociatave, ekspertët ligjorë të BE-së kishin gjetur si formulë që edhe me Kosovën të ketë mundësi të lidhjeve të tilla kontraktuale. Për këtë kishin marrë modelin që përdoret për marrëveshje me “entitetet që nuk janë shtete sovraane”. Në këtë rast, në komunikime të brendshme, ishin përmendur edhe Marrëveshjet me Hong Kongun, Tajvanin, Makaon apo edhe me Autoritetet e Palestinës.

Pos që thotë qartë brenda tekstit se nuk paragjykon qëndrimet e vendeve anëtare karshi statusit, edhe kur flet për disa qëllime Marrëveshja përfshin edhe fjalinë “nëse rrethanat mundësojnë një gjë të tillë”. Marrja e obligimeve të qarta politike nga ana e BE-së për të avancuar në mënyrë evolutive afrimin drejt anëtarësimit me Kosovën mungon në këtë marrëveshje dhe kjo e bën të ndryshme nga ato me vendet tjera.

Në marrëveshjen e Stabilizim Asocimit të nënshkruar në mes të Kosovës dhe Bashkimit Europian, neni 11 i marrëveshjes thotë se dialogu politik në mes të palëve nënshkruese ka për qëllim promovimin e pjesëmarrjes

së Kosovës në komunitetin ndërkombëtar demokratik, me vërejtjen “nëse rrethanat objektive e lejojnë këtë gjë”<sup>8</sup>. Qëllimi tjetër i dialogut politik përshkruhet në formë të “avancimit të perspektivës europiane të Kosovës dhe përafritimit me BE-në” në linjë me perspektiven europiane të rajonit, bazuar në meritat individuale si dhe në përputhje me zotimet e Kosovës, sipas Neni 5 të kësaj marrëveshjeje<sup>9</sup>.

Ndërkohë, në kapitullin rreth dialogut politik, në Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit të nënshkruar në mes të Bashkimit Europian dhe Serbisë, Neni 11 pika 2a, qartë thekson se ky dialog ka për qëllim të promovojë në veçanti integrimin e plotë të Serbisë në komunitetin e popujve demokratikë dhe përafritimin gradual me Bashkimin Europian<sup>10</sup>.

Njejtë edhe në Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit të nënshkruar në mes të BE-së dhe Shqipërisë, Neni 8 që i referohet dialogut

---

8 EU. (2015). *STABILISATION AND ASSOCIATION AGREEMENT BETWEEN THE EUROPEAN UNION, OF THE ONE PART, AND KOSOVO*. Retrieved from [http://ec.europa.eu/enlargement/news\\_corner/news/news-files/20150430\\_saa.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/news_corner/news/news-files/20150430_saa.pdf)

9 Neni 5 i MSA-së i referohet obligimit të palës Kosovare që të angazhohet në përmirësimin e raporteve me Serbinë

10 EU. (2015). *STABILISATION AND ASSOCIATION AGREEMENT BETWEEN THE EUROPEAN UNION, OF THE ONE PART, AND KOSOVO*. Retrieved from [http://ec.europa.eu/enlargement/news\\_corner/news/news-files/20150430\\_saa.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/news_corner/news/news-files/20150430_saa.pdf)



---

politik, në pikën 2, nënvizon integrimin e plotë të Shqipërisë në komunitetin e popujve demokratikë dhe përafrimin gradual me Bashkimin Europian, si një ndër qëllimet e dialogut<sup>11</sup>.

Referenca e qartë se MSA-ja çon drejt integritit të plotë të Kosovës në komunitetin evropian, ashtu siç e kanë të stipuluar vendet tjera të rajonit, mungon në përmbajtjen e marrëveshjes të nënshkruar në mes të Prishtinës dhe Brukselit në vitin 2015.

Në vend të integritimeve Europiane në rastin e Kosovës vazhdimisht përdoret termi “perspektivë europiane” që është përkufizim më i gjërë. Kjo nuk është e rastësishme sepse për disa shtete integrimi nënkupton anëtarësimin në BE dhe kjo mund të paragjykojë se Kosova po trajtohet si shtet<sup>12</sup>.

Por në praktikë, edhe e tillë çfarë është, MSA-ja i mundëson Kosovës që të përfitojë sikur edhe shtetet tjera, pos në aspektin e integritit në BE, nëse me integrim nënkuptohet edhe rruga drejt anëtarësimit. Këtë rrugë MSA-ja nuk e hap në aspektin formal edhe pse zbatim i sajë, në kuptimin e përgatitjes së Kosovës dhe arritjes së standardeve, mund ta ndihmojë atë.

---

11 EU. (2006). *STABILISATION AND ASSOCIATION AGREEMENT BETWEEN THE EUROPEAN COMMUNITIES AND THEIR MEMBER STATES, OF THE ONE PART, AND THE REPUBLIC OF ALBANIA, OF THE OTHER PART*. Retrieved from [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/albania/st08164.06\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/albania/st08164.06_en.pdf)

12 Nga biseda e autorëve me dy diplomatë të dy shteteve që nuk e njohin Kosovën. Ata thonë se në tekste për Kosovën nuk pranojnë asgjë që mund të shihet si trajtim i Kosovës si shtet të pavarur

# Brenda Bashkimit European në përgjithësi pak entuziazëm rreth zgjerimit

---

Në analizën e gjasave për Kosovën në rrugën e saj drejt integritetit europian duhet marrë parasysh edhe vullnetin brenda BE-së për t'u zgjeruar dhe për të pranuar vende të reja anëtare. Ky vullnet me kalimin e viteve po zbehet, dhe po fitohet përshtypja se procesi i zgjerimit po mbahet gjallë më shumë nga frika e destabilizimit të rajonit sesa nga dëshira që këto shtete një ditë të bëhen anëtare të Unionit.

Përbërja e tanishme e Komisionit European, mënyra e zgjerimit në politikën e këtij Komisioni, përfshirë edhe mënyrën si përmendet (në emërtim, pas politikës së fqinjësisë), janë dëshmi e qartë se ky proces nuk është më ndër prioritetet e Komisionit European. Këtë e kishte bërë të qartë edhe vetë Presidenti i Komisionit, Zhan Klod Junker, i cili që në fillim kishte pohuar se gjatë mandatit të tij nuk do të ketë zgjerim<sup>13</sup>.

Ndonëse deklarata e tillë e Junkerit ishte kritikuar, sidomos nga deputetët e Parlamentit European, ajo ishte edhe reale, sepse të gjitha vendet e rajonit janë ende shumë larg prej anëtarësimit në BE. E Kosova në mesin e tyre

---

<sup>13</sup> Me këtë ai nuk ka thënë se nuk do të vazhdojë procesi por se nuk pritet që ndonjë shtet i ri të bëhet anëtarë deri në fund të mandatit të tij pesvjecar

është bindshëm e fundit, nëse fare mund të thuhet se Kosova është në proces formal. Ajo nuk njihet nga pesë shtetet anëtare, ndërsa anëtarësimi në BE është proces në mes të një shteti kandidat dhe të gjitha shteteve ekzistuese anëtare.

Bashkimi European ka bërë të qartë se dëshiron të konsolidohet në brendësi para se të zgjerohet. Kështu, përmbushja e kriterëve që kërkon reforma dhe ndryshime rrënjësore, zhvillim ekonomik, respektim të rendit dhe ligjit, depolitizim të institucioneve publike, krijim të ekonomisë funksionale të tregut, që natyrisht është kushtëzimi që BE-ja u bën vendeve candidate, dhe kandidatëve potencialë, është vetëm njëra anë e procesit. Nëse ato nuk përmbushen nuk do të ketë lëvizje përpara. Por procesi është me një përfundim të paparashikueshëm sepse varet edhe nga gatishmëria e BE-së për të pranuar vende të reja anëtare. Dhe këtu kanë ndodhur ndryshime serioze në Bashkimin European. Kjo ngjau gradualisht, që nga refuzimi i Kushtetutes Evropiane në referendume në Francë dhe Holandë në vitin 2005 e deri te situata aktuale në BE, ku zgjerimi është çështja e fundit që njerëzve u bie ndër mend, ndërsa edhe nëse

---

ndodh – atëherë janë kundër.

E detyruar të merret me veten, BE-ja nga viti 2005 e deri me so, ka pranuar në anëtarësi vetëm Bullgarinë dhe Rumaninë, me të cilat puna ishte kryer edhe para këtyre referendumeve, dhe ka arritur disi ta pranojë edhe Kroacinë në vitin 2013. Ndërkohë, ka pasur lëvizje në procese me vendet tjera por gjithmonë duke e vënë në dyshim përfundimin e procesit.

Disa vende të Bashkimit Europian kanë ndryshuar edhe ligjet dhe përmes këtyre ndryshimeve kanë hapur mundësi edhe për pengesa të reja në procesin e zgjerimit. Në Francë do të ketë referendum për pranimin e secilit vend të ri anëtar në të ardhmen. Në Holandë mjafton që dikush të mbledhë disa qindra mijëra nënshkrime dhe të organizohet referendumi. Më shumë se 70 parlamente të ndryshme në BE, nga ato nacionale e deri tek ato rajonale në disa raste, mund të refuzojnë hyrjen e një vendi në BE. Në secilin hap gjatë procesit të negociatave, mund të ndodhë që madje edhe komisionet parlamentare të ndonjë vendi anëtar, ta ndalin procesin e negociave. Kjo mundësi ekziston së paku 70 herë gjatë procesit<sup>14</sup>.

Shpeshherë, frika nga zgjerimi i BE-së bën që në disa shtete anëtare të kundërshtohen edhe lëvizjet që nuk kanë lidhje direkte me këtë proces. Kështu holandezët kanë refuzuar në referendum Marrëveshjen e Asocimit me Ukaninën. Referendumi në Holandë ka qenë vetëm këshillëdhënës dhe nuk e obligonte qeverinë në aspektin juridik. Por në një vend me demokraci serioze qeveria e respekton

vullnetin e qytetarëve edhe pse nuk i pëlqen. Tash si mundësi për të dalë nga kjo bllokadë, dhe për ta shpëtuar një Marrëveshje për shkak të së cilës Ukraina edhe hyri në luftë me Rusinë, për të dëshmuar se është në anën e BE-së, në Holandë përmendin opsionin që nga BE-ja të kërkohej deklaratë e qartë se me këtë Marrëveshje Ukraina nuk do të ketë mundësi të bëhet anëtare e BE-së.

Sot fitohet përshtypja se për çfarëdo që do të votonin qytetarët në ndonjë vend të Bashkimit Europian e që ka lidhje me BE-në, ata do të votonin kundër. Dhe kjo e bën edhe më të vështirë procesin e zgjerimit.

Në këto rrethana sot BE-ja edhe në komunikim rreth zgjerimit mundohet të dërgojë mesazhe të dyfishta: për opinionin e vendeve anëtare, sidomos atyre perendimore, se në një të ardhme të afërt nuk do të ketë zgjerim, dhe për vendet e Ballkanit, se procesi vazhdon dhe ato duhet të besojnë në të ardhmen e tyre në BE.

Vendimi për largimin e Mbretërisë së Bashkuar nga BE-ja do ta përkeqësojë edhe më shumë situatën për zgjerim. Ky vend, edhe ashtu konsiderohej skeptik ndaj zgjerimit, madje edhe para mbajtjes së referendumit për largim. Megjithatë, Britania e Madhe ishte njëkohësisht edhe ndër vendet më të angazhuara në Ballkan nga të gjitha anëtarët e BE-së. Me largimin e Britanisë do të krijohet një boshllëk i ri në rajon dhe këtë zbrazëtitirë nuk mund ta mbushë vetëm Gjermania nëse nuk do të ketë shumë interes për rajonin nga vendet tjera.

Dhe këtu lind një problem i ri për BE-në e ai është rreziku që zbrazëtitirën ta plotësojnë akterët tjerë ndërkombëtarë të interesuar, e të

---

14 Janë 35 kapituj negociues dhe për hapjen apo mbylljen e secilit prej tyre duhet pajtimi i të gjitha shteteve anëtare

cilët nuk janë më partnerë strategjikë të BE-së por më shumë kundërshtarë të saj. Kjo vlen sidomos për Rusinë e cila edhe në samitin e BE-së në tetor të vitit 2016 u përmend si vend i cili edhe në Ballkan po punon që të dobësojë BE-në<sup>15</sup>.

Shumë shtete janë të vetëdëshme se duhet të kenë kujdes me Ballkanin Perëndimor, ku paqja është arritur por problemet nuk janë zgjidhur në atë mënyrë që të jenë të sigurtë se do të ketë stabilitet afatgjatë dhe të qëndrueshëm. Këtë e tha qartë edhe Kryeministri i ri i Kroacisë Andrej Plenković, duke komentuar vërejtjet për rolin e Rusisë në Ballkan. „Është bindja ime se sa më shumë që BE-ja të hezitojë, sa më e ngadalshme të jetë në politikën e saj të zgjerimit dhe fqinjësisë, aq më shumë hapësirë krijohet për angazhim dhe natyrisht edhe lidhje më të ngushta të këtyre vendeve me Rusinë. Kjo sepse ato nuk e shohin perspektiven e tyre në BE, që është në një mënyrë, nëse doni, edhe legjitime“ ka thënë kryeministri i ri i Kroacisë i cili deri vonë ishte shef i delegacionit të Parlamentit Europian për Ukrainën<sup>16</sup>

Përvoja e fundit në politikën e BE-së, vështirësitë për të miratuar vendimet, dëshmojnë se asnjë shtet i rajonit nuk mund të besojë se është aq i rëndësishëm sa që BE-ja të mos e harrojë dhe ta lërë anash për shkak të hezitimeve brenda saj. Nëse një gjë e tillë ka ndodhur me Ukrainën, ku edhe konflikti filloi për shkak të ndarjes së atyre që duan më shumë lidhje me BE-në dhe atyre që e mbështesin Rusinë, atëherë kjo duhet të jetë vërejtje edhe për pjesë tjera të Europës. Por Ballkani Perëndimor, nëse ka

ndonjë përparësi, ka fatin gjeografik dhe është i rrethuar si enklavë me shtetet e BE-së. Prandaj edhe interesi i BE-së duhet të jetë më i madh për ta vazhduar procesin e zgjerimit me këto shtete. Këtë duhet bërë edhe duke pasur parasysh se procesi i zgjerimit gjithmonë ka qenë edhe proces i ndërtimit të paqës në Europë.

---

15 Deklaratë e Presidentit të Këshillit të BE-së, Donald Tusk, në konferencë për shtyp në Bruksel pas përfundimit të samitit  
16 Nga Konferenca për shtyp në Bruksel pas takimit të Këshillit Evropian me 21 Tetorë 2016



## Konkluzionet

---

Kosova dhe Bashkimi European kanë hyrë në marrëdhënie kontraktuale formale me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje do të jetë sfidë si për Kosovën ashtu edhe për Bashkimin European. Sfidat në anën e Kosovës do të jenë kryesisht për shkak të kapaciteteve implementuese, ndërsa për BE-në sfidat mund të paraqiten në rast se disa shtete anëtare bëjnë pengesa administrative si pasojë e mosnjohjes së Kosovës si shtet. Marrëveshja, duke e lënë mundësinë që disa shtete në raste të caktuara mund të përdorin edhe ligjet nacionale, ka lënë hapësirë e cila mund të krijojë pengesa në zbatimin e saj.

Me këtë Marrëveshje duket se Bashkimi Evropian i ka prekur kufijtë e së mundshmes në raportet me Kosovën, si një vend me perspektivë të integritimit në BE. Kjo Marrëveshje padyshim krijon mundësi të mëdha për Kosovën, të cilat përmenden edhe në këtë punim. Por ajo nuk e hap në mënyrë formale mundësinë e avancimit të Kosovës drejt statusit të kandidatit, e më pas drejt integritimit në formën e anëtarësimit në BE. Ky avancim mbetet peng i mosnjohjes së Kosovës nga vendet anëtare të BE-së. Pasi në Traktatin e BE-së mundësia e kërkesës për anëtarësim përmendet për shtetet, dhe pasi Kosova nuk mund të trajtohet si shtet nga BE-ja, në rastin e Kosovës MSA-ja nuk mund të shihet si një fillim i ri në rrugën drejt integritimit.

Për shkak të rrethanave ekzistuese në BE, zvogëlimit të vullnetit për zgjerim, daljes së

Mbretërisë së Bashkur nga BE-ja, zgjerimi më nuk është ndër prioritetet kryesore. Por procesi është duke vazhduar. Mali i Zi vazhdon negociatat e anëtarësimit duke qenë më i avancuari në këtë proces. Serbia ka hapur kapitujt e parë dhe vazhdon procesin. Shqipëria dhe Maqedonia kanë statusin e kandidatit dhe janë në pritje të mundësisë që të hapin negociatat. Bosnja e Hercegovina ka dorëzuar kërkesën për anëtarësim dhe Këshilli i ka dhënë mandatin Komisionit European që të nisë procedurën e vlerësimit të kësaj kërkesë. Kështu vetëm Kosova ka mbetur me MSA, por pa mundësi që të nisë procedurat e integritimit.

Në BE nuk shihen as përpjekjet për të ndryshuar situatën rreth njohjes së Kosovës nga pesë shtetet të cilat nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Parlamenti European vazhdon të jetë i vetmi institucion i BE-së që Kosovën e trajton si shtet dhe i cili kërkon që atë ta njohin edhe shtetet të cilat nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Thirrjet e tilla nuk vinë as nga Komisioni European as nga Shërbimi i veprimit të jashtëm (EEAS). Situata në disa nga shtetet të cilat nuk e kanë njohur Kosovën është e tillë sa që nuk lë shumë hapësirë për të besuar se do ta njohin Kosovën në një të ardhme të afërt. Prandaj kjo situatë do të vazhdojë të jetë pengesë e pakapërcyeshme për avancimin e Kosovës prej MSA-së drejt statusit të kandidatit.

Bashkimi European është i vetëdijshëm për sfidat që paraqesin siguria dhe stabiliteti i rajonit të Ballkanit Perëndimor për tërë Europën dhe

për BE-në në veçanti. Prandaj edhe dëshiron ta mbajë gjallë procesin e zgjerimit. Por kjo nuk duket e lehtë në kohën kur nga Brukseli dhe nga kryeqytetet e shumë vendeve anëtare vinë mesazhe se nuk do të ketë zgjerim në një të ardhme të afërt. Me këtë BE-ja rrezikon që të humbë në një masë fuqinë tërheqëse që ka në vendet e Ballkanit Perëndimor. Këtu përfshihet edhe Kosova.

Kushtëzimi i përparimit në procesin e integritimeve europiane me bashkëpunimin rajonal duhet të jetë i kujdesshëm. Në rastin e Kosovës nuk duhet ngatërruar gatishmërinë dhe vullnetin për bashkëpunim rajonal me pretendimet territoriale që Serbia ka ndaj Kosovës. Prandaj edhe potenciali i dialogut mes Kosovës dhe Serbisë në Bruksel për të arritur normalizimin gjithëpërfshirës të raporteve i ka kufijtë e vet. Ky normalizim nuk mund të arrihet duke lënë gjithmonë anash çështjen e statusit sepse këto mospajtime rreth statusit bëhen mospajtime territoriale dhe janë burim i tensioneve të raporteve dhe i problemeve tjera teknike.

Procesin e zgjerimit e ka bërë më të ngadalshëm edhe kushtëzimi i dyfishtë. Tani kusht për zgjerim nuk është vetëm gatishmëria e kandidatëve për t'u bërë anëtarë por edhe kapacitetet e BE-së. Formalisht, kështu ka qenë edhe në të kaluarën por në rrethana krejt tjera politike kur zgjerimi ka qenë prioriteti kryesor i BE-së dhe është parë si realizim i idealit të bashkimit të Europës. Por realizimi i këtij ideali nuk mund të konsiderohet i përfunduar pa integrimin e vendeve të Ballkanit në BE. Prandaj, pos procedurave që BE-ja vazhdon ti ndjekë në raportet me vendet e Ballkanit

Perëndimor, nevojitet një rikrijim i vullnetit politik për zgjerimin e BE-së.

## Rekomandimet

---

Kosova duhet të bëjë përpjekje maksimale për të shfrytëzuar të gjitha mundësitë të cilat i ofron Marrëveshja e Stabilizim Asocimit, nga ato tregtare deri tek përfitimi nga asistenca për ndërtimin e kapaciteteve administrative.

Kapacitetet administrative duhet të rriten në mënyrë që të ketë sukses në zbatimin e MSA-së. Kjo nuk zbatohet me deklarata politike por me punë në terren. Këto kapacitete duhet të ndërtohen në të gjitha ministritë, si dhe në nivelin lokal.

Debati se a e konsideron MSA-ja Kosovën shtet apo jo është i kotë. Vetë marrëveshja e bën të qartë këtë. Kjo nuk duhet të përdoret si arsytim për dështime në implementimin e marrëveshjes.

Kosova duhet të insistojë se duhet të njihet nga të gjitha shtetet anëtare dhe përfaqësuesit e saj nuk duhet të deklarojnë se kanë mirëkuptim për qëndrimet e Serbisë dhe të shteteve të cilat nuk e njohin Kosovën.

Kosova duhet të vednosë në një moment nëse do ta sfidojë apo jo BE-në duke dorëzuar kërkesën formale për anëtarësim.

BE-ja duhet të sigurojë që Kosova të mos diskriminohet në krahasim me vendet tjera në procesin e implementimit të MSA-së. Duhet të punojë më shtetet anëtare që ato të mos e përdorin mosnjohjen për të penguar zbatimin e saj.

Strukturat e BE-së të cilat janë të përfshitra në procesin e zgjerimit duhet të kërkojnë nga shtetet anëtare që të krijojnë unitet në qëndrime rreth statusit të Kosovës. Me këtë do t'i ndihmonin edhe Serbisë që më lehtë të pranojë realitetin e ri - se Kosova është shtet i pavarur.

BE-ja duhet të ketë kujdes që të mos lërë zbrazëti në rajonin e Ballkanit Perendimor të cilën mund ta përdorin akterët tjerë ndërkombëtarë, si për shembull Rusia, për të sfiduar edhe BE-në dhe për ta mbajtur rajonin si zonë e konflikteve të ngrira.

BE duhet të gjëjë forcë që, edhe në kohën kur për herë të parë nis procesi i shpërbërjes së saj, ta vazhdojë procesin e zgjerimit si një proces jo vetëm ekonomik dhe teknik por edhe proces i vazhdueshëm i ndërtimit të paqes në Evropë.



---



**Augustin Palokaj** është korrespondent nga Brukseli për gazetat Koha ditore nga Kosova dhe Jutarnji List nga Kroacia që nga viti 1998. Në përvojën e tij shumëvjeçarë ka raportuar për proceset e zgjerimit të Bashkimit Evropian dhe NATO-s, për zhvillimet brenda këtyre organizatave. Pos shkrimeve të rregullta në gazeta për proceset integruese ka shkruar edhe analiza dhe ka mbajtur ligjërata në shumë vende të rajonit të Ballkanit dhe të vendeve të BE-së. Shkollimin fillorë dhe të mesëm e ka kryer në Pejë ndërsa ka magjistruar gazetarinë në Fakultetin e shkencave politike të Universitetit të Zagreb në Kroaci. Gjatë kohës së luftës në Kroaci dhe Bosnje e Hercegovinë ka qënë korrespondent i shërbimit botërorë të BBC-së dhe i javores Koha nga redaksia e së cilës më vonë doli edhe Koha ditore. Ka shkruar dhe për gazetat gjermane nga grupi medial WAZ. Për punën e tij si gazetarë është shpërblyer në Kosovë dhe në Kroaci.



**Gjeraqina Tuhina** është korrespondente nga Brukseli për Radio Televizionin e Kosovës nga viti 2000. Ajo mbulon procesin e zgjerimit të Bashkimit Evropian, si dhe marrëdhëniet BE-Ballkan. Profesionin e gazetares e ka filluar nga viti 1996 në BBC, e më pas ka raportuar mbi luftën në Kosovë për IWPR për tri vite. Ka punuar si gazetare për gazetën koha, për tu bërë më pas korrespondentë e Radio Evropa e Lirë. Përveç punës si gazetare, ka punuar si konsulente në European Perspective for Kosovo, si dhe është angazhuar në trajnime të gazetarëve në Bratislavë me C&M consulting. Tuhina ka magjistruar në Studime të Komunikimit dhe Mediave në Vrije Universiteit Brussel, kurse mbanë diplomë nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës.